## AKT - THEMELIMI

## I SHOQËRISË PRIVATE SH.P.K. " K O L O S E U "

Sot më dt.16 Mars 1999 ne ortakët themeluesë :
1) Jani Qose i biri i Todit, i dt. 1962 , banues në Ura Vajgurore
2) Llazar Mafiqi i biri i Dhimitrit, i dt. 1965 , banues në Ura Vajgurore
deklarojmë se themelojmë Shoqërinë Private SH.P.K. " KOLOSEU" .

Selia e kësaj shoqërie private është Komuna e Urës Vajgurore e rrethit Berat . Rrethi i veprimtarisë së sajë private është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë dhe jashtë sajë .

SH.P.K. " KOLOSEU" ka si objekt të veprimtarisë së sajë :
- Prodhimi i gurit, granil , çakull , gëlqere , materiale të ndryshme ndërtimi , parafabrikate si dhe materiale e artikuj të tjerë të ndërtit pa kufi , tregëtimi i tyre me shumicë dhe pakicë import - eksport .
- Projektimi dhe ndërtimi i objekteve dhe veprave të ndryshme .

Për fillimin e veprimtarisë private kjo Shoqëri ka një kapital fillestar prej 100 000 lekë e cila është kontribut i përbashkët i dy ortakëve në pjesë të barabarta .

Afati i ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj Shoqërie është mbi 10 vjet pa ndërprerje .

SH.P.K." KOLOSEU" ka llogarinë e sajë në Bankën Kombëtare Tregëtare Dega Berat .

Administratori i kësaj Shoqërie është Z. Jani Qose .

Marrëdhëniet midis ortakëve dhe të Shoqërisë me persona të tjerë të tretë do të rregullohen dhe zgjidhen në bazë të Statutit dhe të dispozitave ligjore në fuqi të shtetit shqiptar .

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e kësaj Shoqërie do të ndahet midis ortakëve themeluesë në pjesë të barabarta .

Sa më sipër u lexua dhe nënshkruhet pavërejtje nga ortakët themeluesë të kësaj Shoqërie .

ORTAKËT THEMELUESË

JANI QOSE      LLAZAR MAFIQI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE EDLIRA HIRO
Nr. 2111 vep.

V E R T E T I M

Sot më dt. 16.03.1999 para meje Noteres Edlira Hiro u paraqitën ortakët themeluesë të mësipërm të cilët deklaruan se kanë hartuar dhe nënshkruar me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë aktin e themelimit të mësipërm dhe kërkojnë që Noteria e vertetojë rregullisht .

N O T E R E
Edlira Hiro

# S_T_A_T_U_T
## I SHOQËRISË PRIVATE SH.P.K. " K O L O S E U "

Në bazë të aktit të themelimit të dt. 16.03.1995 është krijuar Shoqëria Private SH.P.K. " KOLOSE U" .

Themeluesit e kësaj Shoqëris private janë Jani Qose dhe Llazar Mafiqi .

### EMRI , QNËDRA , TERRITORI

Neni 1

Emri i Shoqërisë private SH.P.K. të krijuar ngaortakët themeluese Jani Qose dhe Llazar Mafiqi është " KOLOSE U" .

Neni 2

Selia e SH.P.K. "KOLOSE U" është Komuna e Urës Vajgurore të rrethit Berat .

Neni 3

Shoqëria private "KOLOSE U" do të ushtrojë veprimtarinë e sajë private në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jasht sajë .

Neni 4

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë private të Shoqërisë është:
- Prodhimi i gurit, granilit, gëlqeres, çakullit , materialeve të ndryshme tëndërtimit , parafabrikate dhe çdo lloj materialidhe artikulli ndërtimi , tregëtimi i tyre me shumicë dhe pakicëimport - eksp
- Projektimi dhendërtimi i objekteve të ndryshme dhe veprave të ndryshme .

Neni 5

SH.P.K. " KOLOSE U" do të ushtrojë veprimtarinë esajë private për [illegible] kohe mbi 10 vjet pandërprerje .

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë private SH.P.K. " KOLOSEU" përbëhet prej : 100 000 lekë i cili është kontribut i përbashkët i të dy ortakëve themeluesë të sajë në pjesë të barabarta .
me vendim të dy ortakëve themeluesëdhe me zgjerimin e aktivitetit të sajë Shoqëria mund të shtojë dhe kapitalin fillestar të sajë .

Neni 7

Transferimi i kapitamitf fillestar do të bëhet me vendim të ortakëve themeluesë dhe me akt noterial. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe në rrugë trashëguese .

Neni 8

Pjesët e kapitalit fillestar mund tu transferohen edhe personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri .

Neni 9

Me miratimin e ortakëve themeluesë në këtë Shoqëri mund të pranohen dhe ortakë të tjerë të cilët do të bashkojnë kapitalet e tyre meatë të Shoqërisë .

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 10

SH.P.K. " KOLOSEU" do të drejtohet nga ortakët themeluesë të sa
Administratorët do të caktohen me vendimtë ortakëve themeluesë .

Neni 11

Administratori i kësaj Shoqërie është emëruar Z. Jani Qose . A
ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e Shoqërisë . Kompetencat
e tij janë /
Disponon firmën në Bankë në llogarinë përkatëse të kësaj Sho

qërie dhe merr përsipër të gjitha problemet financiare të sajë
- merr dhe jep hua lidh kontrata me të tretët për veprimtarinë e
Sh.P.K. " KOLOE U"me partnerë të huaj dhe vendas .
- Vendos për marrjen dhe largimin nga puna të punonjësve , nxjerrjen
e tyre në asistencë si dhe mënyrën e shpërblimit të tyre .
- Mban rregjistrin themeltar të punonjësve , evidenton punën e tyre
dhe kur është rasti merrmasa disiplinore sipas legjislacionit në
fuqi dhe të kushteve tëparashikuara në kontratën e punës .
- cakton dhe jep lejet e zakonshme .
- Ndjek ritmikisht aktivitetin e Shoqërisë , cakton ekspertin kontabël për kryerjene e llogarive tësajë .
- Kryen në kohë dhe me cilësi të gjitha veprimet për likujdimet nda sistemit fiskal .

Neni 12

Ortakët themeluesë të kësaj Shoqërie mund të emërojnë si administratorë edhe një person të jashtëm duke i caktuar pagën dhe detyrat e tijë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e kësaj Shoqërie .

Neni 13

Ortakët themeluesë të Shoqërisë mund të emërojnë punonjës për kujdestari të veçantë. Po kështu ata mund të emërojnë dhe një Këshill administrativ me ose pa të drejtë vote vendimore .

Neni 14

Administratori i kësaj Shoqërie e humbet detyrën me tijë me rastin e prishjes së Shoqërisë ose me vendim të ortakëve themeluesë.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 15

Shoqëria Private Sh.P.K. " KOLOE U" përfaqësohet nga ortakët themeluesë të sajë . Ata mevendim të tyre kanë të drejtë të autorizojnë një person tjetër për të përfaqësuar Shoqërinë .

Administratoret e emëruar nga ortakët themeluesë kanë kopetencë të zbatojnë të gjitha rregullat dhe udhëzimet e dhëna nga

ortakët themeluesë dhe në bazë të aktit të themelimit ose në proçes-verbal të veçantë.

A S A M B L E A

Neni 16

Asamblea është organi vendimor i Shoqërisë . Ai përbëhet nga ortakët themeluesë dhe nga punonjës të tjerë pa të drejtë vote.

Neni 17

Asamblea si rregull thirret duke njoftuar 15 ditë para mbledhjes me letër korrespondencë . Në të tregohet dita , ora dhe materialet që do të trajtohen në mbledhje . Secili prej ortakëve mund të përfaqësohet në mbledhje nga ortaku tjetër .

Asamblea vendos për problemet kryesore të Shoqërisë duke patur parasysh dispozitat ligjore në fuqi dhe Statutin e Shoqërisë .

MBI KONTROLL E VIZIONIN

Neni 18

Ortakët themeluesë kanë të drejtë të caktojnë dhe kontrollorët e Shoqërisë . Po kështu ata caktojnë ekspertë për veprimtarinë ekonomiko financiare të Shoqërisë .

Pagat e kontrollorëve dhe të ekspertëve caktohen me vendim unanim të ortakëve themeluesë .

BALANCI I TË ARDHURAVE

Neni 19

Veprimet e Shoqërisë mund të mbyllen në Datën 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ortakët themeluesë administratorët dhe ekspertët kontabël të Shoqërisë nxjerrin bilancin kontabël të saj , rezultatin ekonomik të fitimit , humbjet sipas ligjit .

Neni 20

Të ardhurat do të realizohen nga veprimtaria private e Shoqërisë. Çmimet dhe tarifat e shërbimeve do ë caktohen me vendim unanim të ortakëve themeluese si dhe në përputhje me kërkesë ofertën e dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto marëdhënie .

Neni 21

Të ardhurat qëdo të rezultojnëpas zbritjes së tatim fitimit, krijimit të fondeve të zhvillimit , detyrimet e tjera , do të mbeten pasuri e të dy ortakëve themeluese të Shoqërisë . Kjo pasuri do të ndahet midis tyre në pjesë të barabarta në përputhje me kontributin në kapitalin e themelimit .

MARËDHENIET E PUNËS

neni 22

marëdhëniet e punës në këtë Shoqëri private rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për problemet që nuk parashikohen në kontratë zbatohen dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto marëdhënie .

Neni 23

Shoqëria Private SH.P.K. " KOLOSEU" merr përsipër të respektojn rregullat në fuqi të punësimit , të Sigurimeve Shoqërore Shtetrore për të gjithë punonjësit , kurse punonjësit jë të detyruar të respe tojnë këtë Statut dhe ligjet në fuqi .

Neni 24

Të punësuarit përgjigjen sipas ligjit dhe këtij Statuti . Për mosrespektim të detyrave dhe për dëmete shkaktuara ai do të përgj gjet sipas ligjit .

Administratorët mbajnë përgjegjësi penale dhe civile për kryer jen e detyrave të tyre .

Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e Shoqërisëdhe pas largimit të tyre nga kjo Shoqëri .

Neni 25

Shpërbërja e Shoqërisë bëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkaku. Mënyrat e likujdimit të Shoqërisë janë kopetencë ekskluzive e ortakëve themeluesë. Ata caktojnë një ose më shumë likujdatorë për të nxjerrë rezultatet eaktivitetit të Shoqërisë .

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 26

Shoqëria private SH.PK. " KOLOSEU" është person juridik i pavaru Ajo ka të drejta dhe detyeime përtë cilat përgjigjet në bazë të ligjit . Të drejtat dhe detyrimete Shoqërisë janë të parashikuara në ligjin Nr. 7512 dt. 10.08'1991 dhe në Kodin Tregëtar .

Neni 27

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e sajë private në bazë të tregut të lirë .
Themeluesit e kësaj Shoqërie kanë derdhur kapitalin e tyre me qëllim që të realizojnë të ardhura dhe të përballojnë humbje deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin e themelimit.

Neni 28

Shoqëria Private SH.P.K. " KOLOSEU" është person juridik dhe e fiton zotësinë e sajë juridike për të vepruar nga datae rregjistrimittë sajë në Gjykatën e rrethit Tiranë .

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Themeluesit e kësaj Shoqërie Private me rastin e shtimit të ortakëve kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në Statut dhe të hartojnë njëkohësisht dhe kontrata të përbashkëta me ortakët e tjerë. Ndryshimet e bëra në Statut duhet të pasqyrohen dhe në rr gjistr Tregëtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë .

Neni 30

marëdhëniet e Shoqërisë Private SH.P.K. " KOLOSE U" me të tretët me me persona të tjerë fizik a juridik vendas ose të huaj do të zgjidhen në bazë të ligjit shqiptar ose të marrëveshjeve të bëra midis palëve .

Ky Statut u hartua në katër kopje , në gjuhën shqipe . Një kopje e Statutit mbetet si dokumentacion formues pranë Gjykatës së rrethit Tiranë .

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

JANI QOSE                LIAZAR ZMAFIQI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE EDLIRA HIBRO
Nr. 211 vep.

V E R T E T I M

Sot më dt. 16.03.1995 para meje Noteres Edlira Hibro u paraqitën ortakët themelues të mësipërmtë cilët deklaruan para meje se kanë hartuar dhe nënshkruar me dëshirën dhe me vullnetin e tyre të lirë Statutin e mësipërm. Unë Noteria duke parë se veprimi i mësipërm është i njëjtë me ligjon dhe vullnetin e tyre e vërtetojë atë .

N O T E R E
Edlira Hibro

PULLE TARSE
R.SHQIPERISE